



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 897/1 prot.

Tiranë, më 25.11.2024

VENDIM
Nr. 75, datë 25.11.2024

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 16, DATË 15.02.2023

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 16, datë 15.02.2023, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Ministria e Kulturës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar parregullsitë e konstatuara”.

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 106 (570 prot.), datë 15.7.2022, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatën e Ministrisë së Kulturës”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë kryerjes së procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatën e Ministrisë së Kulturës, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, nga zyrtarët e ngarkuar prej ligjit për realizimin e këtij procesi.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 16, datë 15.02.2023, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në

institucionin Ministria e Kulturës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar parregullsitë e konstatuara”, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri, me shkresën nr. 155/3 prot., datë 04.09.2023, “*Kërkohet informacion mbi zbatimin e Vendimit nr. 16, datë 15.2.2023, të Komisionerit për rregullimin e ligjshmërisë*”, ka kërkuar nga institucioni informacion mbi ecurinë e procesit dhe veprimet e ndërmarra në përmbushje të detyrimeve të vendosura në dispozitivin e këtij vendimi.

Me shkresën nr. 4596/1 prot., datë 20.09.2023, “*Dhënie informacioni mbi zbatimin e Vendimit nr. 16, datë 15.02.2023, të Komisionerit, për rregullimin e ligjshmërisë*”, institucioni Ministria e Kulturës ka njoftuar Komisionerin për masat e marra.

Në kushtet kur, përgjigjja e institucionit nuk ishte ezauruese, Komisioneri, në datën 16 shtator 2024, i është drejtuar me anë të komunikimit elektronik Departamentit të Administratës Publike, duke kërkuar një informacion për të gjitha ministritë që i janë nënshtruar procesit të mbikëqyrjes me objekt vlerësimet e punës të nëpunësve civilë. Ky i fundit, me e-mailin e datës 14 tetor 2024, i është përgjigjur kërkesës së Komisionerit, duke parashtruar situatën e ecurisë së procesit në këto institucione.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 16, datë 15.02.2023, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Ministrisë së Kulturës paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikat 2 - 9, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet e ngarkuara nga ligji me detyra të posaçme në administrimin e shërbimit civil gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë (*zyrtarët raportues, kundërfirmues dhe autorizues*) të marrin masat si më poshtë:

- Të plotësojnë hapësirat përkatëse të dedikuara për komente dhe shpjegime;
- Në rastin e vlerësimeve të pjesshme për shkak të largimit të zyrtarëve që duhet të bëjnë vlerësimin, zyrtari raportues zëvendësues që përmbyll procesin, të bëjë vlerësimin përfundimtar për gjithë periudhën 6-mujore të vlerësimit;
- Zyrtarët kundërfirmues të sigurojnë një vlerësim objektiv, i cili duhet të pasqyrojë kriteret e politikës së përgjithshme; Zyrtarët raportues të identifikojnë kërkesat e nëpunësve të vlerësuar për trajnim dhe mundësi zhvillimi të veçantë profesional;
- Zyrtarët kundërfirmues të mbajnë kontakte të rregullta me zyrtarët raportues, të identifikojnë nevojat e tyre për trajnim, duke i adresuar ato pranë Zyrtarit autorizues për të siguruar një ecuri normale të sistemit të vlerësimit;
- Zyrtari autorizues, si përgjegjësi kryesor i sistemit të vlerësimit, të sigurojë që aktorët pjesëmarrës në këtë proces të kenë njohuri të plota për realizimin e procedurës së vlerësimit, në përputhje me standardet e kërkuara nga vendimi nr.109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave;

- Të hartohet një plan trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta që ju vendos zyrtarëve të vlerësimit legjislativ i shërbimit civil. Ky plan t'i njoftohet zyrtarisht njësisë përgjegjëse DAP dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA);
- Njësia e burimeve njerëzore të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil.

Referuar e-mailit të datës 14.10.2024, të njësisë përgjegjëse (DAP), dërguar Komisionerit, si dhe shkresës nr. 4596/1 prot., datë 20.9.2023, të Ministrisë së Kulturës, theksohet se detyrat e lëna për vlerësimet e nëpunësve civilë deri në nivelin e mesëm drejtues janë zbatuar referuar përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi.

Në lidhje me rekomandimin për hartimin e një plani trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave që ju vendos zyrtarëve të vlerësimit legjislativ i shërbimit civil, Ministria e Kulturës, ka informuar Komisionerin se, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Departamenti i Administratës Publike janë në komunikim të vazhdueshëm me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit për trajnimin e zyrtarëve që kanë rol aktiv në hartimin e vlerësimit të punës.

Në pikën 10 të vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka lënë detyrë Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, të drejtojë procesin e vlerësimit për TND-në, në mënyrë që formularët e vlerësimit të plotësuar dhe të nënshkruar nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, t'i përcillen zyrtarisht nëpunësve civilë anëtarë të TND-së, të emëruar në këtë ministri.

Rezulton se, për zbatimin e kësaj pike, Departamenti i Administratës Publike, me anë të komunikimit elektronik të datës 14.10.2024, ka informuar Komisionerin se përsa i takon vlerësimeve për TND-në, ato janë në fazë shqyrtimi dhe diskutimi së bashku me ministritë e linjës për finalizimin e këtij procesi.

Për sa u përshtrua më sipër, vlerësoj se, nga ana e institucionit janë zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri në pikat 2 - 9 të dispozitivit të vendimit.

Ndërsa sa i takon vlerësimeve për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, nisur nga kompleksiteti i veprimeve që duhet të kryhen në këtë rast, si dhe nga organizmi specifik që duhet t'i kryejë këto veprime, bazuar edhe në pikën 4, të nenit 36, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, (e ndryshuar), propozojmë që pika 10 e vendimit të jetë objekt i kontrollit gjatë mbikëqyrjes së radhës në subjekt ose mbikëqyrjes së orientuar që ushtrohet në vijimësi gjatë gjithë vitit, ku informacioni mbi ecurinë e procesit dhe realizimin e detyrës nga ana e Ministrisë së Kulturës t'i përcillet inspektorit që e mbikëqyr këtë subjekt.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 16, datë 15.02.2023, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Ministria e Kulturës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar parregullsitë e konstatuara”, për pikat 2 - 9 të dispozitivit të këtij vendimi, për shkak të rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Ministria e Kulturës, duke zbatuar detyrat e lëna në pikat 2 - 9 të dispozitivit të Vendimit nr. 16, datë 15.02.2023.
3. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në përfundim të procesit të vlerësimeve për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, të njoftojë Komisionerin në lidhje me realizimin e detyrës në pikën 10, të vendimit 16/2023, të Komisionerit. Realizimi i kësaj pike do të ndiqet nga Komisioneri në mbikëqyrjen e rradhës në këtë institucion.
4. Për këtë vendim të njoftohet njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha